# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451044**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 persona - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/operacion-antidroge-ne-korce-arrestohen-3-persona/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 06:42:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 06:37:12 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `25c6ac1d1af9a1789bc4b6e2d48840e16b678ee3e90467785afcf0785d16f29d` |
| TEKSTI | `77cdeaf2afa38b150e691fea7505338db12d7c5751e6320c5875ad1531c32da9` |
| PAMJA | `0608f886500e3ca33ac2a230c7943020759a57537c221ce85057404611c103fd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `62b501e76d4c00db6b0905e49a4c61117aeadeb99f392d9a4531f46fdd1e6ebc` |
| E MËPARSHMJA | `e0dbe4ffabdffb8bbcb828f415df78942e0cb4f5f251f6f2c5abedfca3b4c7ee` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/62b501e76d4c00db6b0905e49a4c61117aeadeb99f392d9a4531f46fdd1e6ebc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 persona

17 Shtator 2026 | 08:37

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Tre persona janë vënë në pranga mbrëmjen e së mërkurës në Korçë në përfundim të një operacioni antidrogë. Operacioni u zhvillua nga Strukturat e Hetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Sipas informacioneve tre të rinj, dy prej tyre nga Tirana dhe një nga Lezha, kanë rënë në pranga pasi janë kapur duke transportuar në mjet lëndë narkotike cannabis sattiva.

Burime bëjnë me dije se tre të rinjtë udhëtonin së bashku në një automjet ndërsa gjatë ndalimit të tyre në afërsi të Qafë Thanës, brenda automjetit u gjet një sasi droge e vendosur në pjesën e bagazhit.

Mësohet se sasia e drogës është rreth 6 kg ndërkohë që pasagjerit në mjet ju gjet edhe një qese tjetër e vogël në xhep. Krahas sekuestrimit të drogës, po ashtu në cilësinë e provës materiale janë mjeti, shuma parash në euro dhe lek dhe aparate celulare.

Në pranga nga policia ranë S.T., J.P., nga Tirana, përkatësisht 27 dhe 26 vjeç dhe B.H., nga Lezha 25 vjeç. Vijojnë hetimet nga ana e policisë për zbardhjen e plotë të rrethanave, për të zbuluar nëse ka dhe persona të tjerë të përfshirë.

“Korçë/Vijojnë goditjet ndaj veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve. Finalizohet operacioni i koduar “Ngarkesa”.

Transportonin 5.7 kg lëndë të dyshuar narkotike Cannabis Sativa, me qëllim shitjen, kapen në flagrancë në aksin rrugor “Prrenjas-Pogradec” dhe vihen në pranga 3 shtetas.

Sekuestrohen sasia e lëndës narkotike, 2 automjete, 4 celularë dhe një shumë parash. Si rezultat i hetimeve të kryera me metoda proaktive, gjatë 1 jave, për goditjen e veprimtarive kriminale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Seksionin për Mbështetjen Operacionale të Hetimit të DVP Korçë, finalizuan operacionin e koduar “Ngarkesa”.

Në kuadër të këtij operacioni, u arrestuan në flagrancë shtetasit: S. T., 27 vjeç, dhe J. P., 26 vjeç, banues në Tiranë, dhe B. H., 25 vjeç, banues në Shëngjin.

Këta shtetas u kapën nga shërbimet e Policisë, në aksin rrugor “Prrenjas-Pogradec”, duke qarkulluar një automjet me karroceri që drejtohej nga shtetasi J. P. Në karroceri ishte ngarkuar nje automjet tip “Volkswagen”, në bagazhin e të cilit, në vendin e gomës rezervë, u gjet një sasi lënde e dyshuar narkotike Cannabis Sativa, me peshë 5. 7 kg.

LAJMI I FUNDIT

09:06 Lufta tregtare, BE-ja i kërkon Kinës të kufizojë eksportet e makinave hibride

09:05 Snapchat i hapur për të vendosur kufizime kohore për adoleshentët

08:57 Dyshime për abuzim ndaj një 12-vjeçareje, në pranga dy të afërmit e të miturës në Tiranë

08:49 Sulmet ruse në Kiev dhe Odesa, plagosen 18 persona

08:45 Sulm me raketa dhe dronë ndaj një anijeje amerikane pranë Ngushticës së Hormuzit

08:37 Pas tubimit te Qeveria, një grup qytetarësh u zhvendos para selisë së EULEX-it dhe hodhi një mjet piroteknik

TESTIM

Gjatë kontrollit fizik, shtetasit S. T. iu gjet një sasi lënde e dyshuar narkotike Cannabis. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim", njofton policia.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### Dyshime për abuzim ndaj një 12-vjeçareje, në pranga dy të afërmit e të miturës në Tiranë

Policia e Tiranës ka arrestuar dy persona, të dyshuar për abuzim seksual ndaj një vajze 12-vjeçare. Në pranga kanë rënë tezja e saj, 32 vjeçe,...

08:57 | 17/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

### 5 interpelanca sot në Kuvend, protestë jashtë Parlamentit

Këtë të enjte do të zhvillohet në orën 10:00 seanca e radhës plenar në Kuvend. Gjithashtu jashtë Parlamentit do të mbahet një protestë nga qytetarët....

08:11 | 17/09/2026

AKTUALITET | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

### Tafani: Po të ishte gjallë Adem Jashari, do ishte dënuar

Analisti Endri Tafani ka kritikuar ashpër vendimin e gjykatës lidhur me ish-pjesëtarët e UÇK-së. Tafani ka ngritur shqetësimin se UÇK-ja po trajtohet tashmë jo si...

23:04 | 16/09/2026

**TEMA**

Vendi
Rajoni
Bota
Video

**SHËRBIME**

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

**KOMPANIA**

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni
Punësimi

**Follow Euronews on all platforms:**

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.